

Kapacitetet dhe pavarësia e institucioneve për ndihmë shtetërore

Shkurt 2020



Kapacitetet dhe pavarësia e institucioneve për ndihmë shtetërore

Autor: Instituti GAP

Shkurt 2020



Group for Legal
and Political
Studies

Grupi për Studime Juridike dhe Politike

“Rexhep Luci” rruga 16/1

Prishtina 10 000,

Webfaqja: www.legalpoliticalstudies.org

E-mail: office@legalpoliticalstudies.org

Tel/fax.: +383 38 234 456



Instituti GAP

“Sejdi Kryeziu” nr. 4/4

Prishtina 10 000,

Webfaqja: www.institutigap.org

E-mail: info@institutigap.org

Tel/fax.: +383 38 609 339



Prishtina Institute for Political Studies

Instituti i Prishtinës për Studime Politike

“Rexhep Luci” rruga 15/5

Prishtina 10 000,

Webfaqja: www.pips-ks.org

E-mail: info@pips-ks.org,

Tel/fax.: +383 38 224 577

Opinionet e shprehura në këtë dokument jo domosdoshmërisht pasqyrojnë qëndrimet e donatorëve apo anëtarëve të bordit të Grupit për Studime Juridike dhe Politike, Institutit GAP apo Institutit të Prishtinës për Studime Politike. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet apo përdoret në çfarëdo forme pa leje paraprake. Për kërkesa të kësaj natyre kontaktoni zyrën administrative të Grupit për Studime Juridike dhe Politike, Institutin GAP apo Institutin e Prishtinës për Studime Politike.

Hyrje

Dhënia e ndihmës shtetërore për subjekte të ndryshme, qoftë ajo në formë të skemës apo ndihmës individuale, kategorizohet në ndihmë shtetërore të lejuar dhe të ndaluar. Rëndësi të veçantë në këtë fushë merr rregullimi i ndihmës së ndaluar për shkak të ndikimit negativ që mund të ketë në zhvillimin e konkurrencës në një sektor, duke krijuar pozitë dominuese për ndonjë subjekt të caktuar dhe duke mbyllur tregun për akterë tjerë. Prandaj, puna dhe pavarësia e institucioneve në trajtimin e ndihmave individuale dhe skemave të ndihmës shtetërore janë shumë të rëndësishme për ekonominë e vendit. Ato shërbejnë për të ruajtur paranë publike dhe për të mbrojtur konkurrencën në treg.

Kosova dhe shtetet fqinje, sikurse Shqipëria, Mali i Zi, Serbia dhe Maqedonia e Veriut, janë palë nënshkruese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë (TKE). Nga ky traktat burojnë obligime për palët lidhur me transpozimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian (BE-së) mbi energjinë elektrike, konkurrencën dhe mjedisin në legjislacionin e vendit nënshkrues. Sa i përket ndihmës shtetërore, neni 18 i Traktatit, që është i ngjashëm dhe korrespondon me nenin 107 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE), kërkon nga anëtarët e TKE të ndalojnë ndihmën shtetërore e cila dëmton konkurrencën dhe ndikon në tregtimin e energjisë në mes të Palëve Kontraktuese.¹ Gjithashtu, si palë nënshkruese të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), këto shtete obligohen, në bazë të nenit 75(c) të kësaj marrëveshjeje, që të mos përkrahin subjekte përmes ndihmës shtetërore në rast se mund të ndikohet konkurrenca.² Edhe Marrëveshja e Tregtisë së Lirë për Vendet e Ballkanit Juglindor (CEFTA), nënshkruese dhe anëtare e së cilës janë këto shtete, ndalon dhënien e ndihmës shtetërore që deformon konkurrencën dhe dëmton tregtinë mes vendeve anëtare.³ Po ashtu, përgjegjësia për ndalimin e ndihmës shtetërore buron edhe nga ligjet nacionale të cilat i kanë miratuar këto shtete.

Mos-vlerësimi i projekteve të ndihmës shtetërore nga institucionet ka kosto të shumta. Shtetet mund të përballen me padi në gjykatat vendore nga akterët të cilët janë dëmtuar, në sektorë në të cilët është dhënë ndihmë shtetërore. Kjo mund të rezultojë në dëmtim të buxhetit shtetëror, pasi që akterët duhet të kompenzohen për të gjitha humbjet që i kanë pësuar si rrjedhojë e konkurrencës së deformuar me të cilën janë përballur. Gjykata mund edhe t'i anulojë kontratat dhe kërkojë kthimin e ndihmës së dhënë për ta rikthyer konkurrencën në tregun e brendshëm. Po ashtu, kjo përbën shkelje të marrëveshjeve të nënshkruara nga këto shtete sikurse ajo e MSA-së. Rrjedhimisht, lejimi i skemave të ndihmës shtetërore në këto shtete mund ta komplikojë procesin e negocimit për anëtarësim në BE.

Në këtë raport, Instituti GAP krahason kornizën institucionale për ndihmën shtetërore të Kosovës dhe shteteve fqinje, me fokus në analizimin e punës së institucioneve të Kosovës lidhur me projektet nga fusha e energjisë. Raporti vë në pah varësinë financiare nga qeveria të disa institucioneve të ndihmës shtetërore të Ballkanit Perëndimor, që mund të rezultojë edhe me konflikt interesi të këtyre institucioneve gjatë vlerësimit të rasteve dhe marrjes së vendimeve. Po ashtu, nga analizimi i punës së institucioneve të ndihmës shtetërore në Kosovë, me fokus në trajtimin e projekteve nga fusha e energjisë, del se këto institucione nuk janë duke e marrë për vlerësim projektin për ndërtimin e termocentralit “Kosova e Re” lidhur me prezencën e ndihmës shtetërore. Raporti rekomandon që institucionet e ndihmës shtetërore duhet të marrin në trajtim të gjitha projektet për të cilat ekzistojnë indikacione që ka prezencë të ndihmës shtetërore, sidomos projektin “Kosova e Re” si njërin nga projektet më të mëdha infastruktore në vend që nga paslufta.

1 Rregullat e Ndihmës Shtetërore dhe Efektivitetit të Kontrollit të Ndihmës Shtetërore në Sektorin e Energjisë Elektrike sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Burimi: <https://bit.ly/2QD8Nvz>.

2 Marrëveshja e Stabilizim Asociimit mes Bashkimit Evropian, në njërën anë, dhe Kosovës në anën tjetër. Neni 75(c). Burimi: <https://bit.ly/2UKEuAY>.

3 CEFTA. Marrëveshje për amendimin dhe zgjerimin e marrëveshjes së tregtisë së lirë të Evropës qendrore. Neni 21. Burimi: <https://bit.ly/2tsinq6>.

(Pa)varësia e institucioneve të ndihmës shtetërore

Mënyra e funksionimit dhe statusi i institucioneve që trajtojnë çështjet e ndihmës shtetërore në Kosovë dallon nga disa vende tjera të Ballkanit Perëndimor. Institucionet e ndihmës shtetërore janë dizajnuar në forma të ndryshme në këto shtete, ku një pjesë e tyre operon në formën ku departamenti i cili bën vlerësimin e skemave apo ndihmave individuale është pjesë e institucioneve brenda qeverisë e organi vendimmarrës është i pavarur, ku të dyja institucionet janë të pavarura apo tërësisht nën ombrellën e qeverisë.

Në Kosovë, institucionet që trajtojnë fushën e ndihmës shtetërore janë Departamenti i Ndihmës Shtetërore (DNSH) dhe Komisioni i Ndihmës Shtetërore. DNSH funksionon në kuadër të Ministrisë së Financave dhe ka për detyrë të bëjë vlerësimin e skemave dhe propozimeve për ndihmë shtetërore, të mbledhë të dhëna lidhur me ndihmën shtetërore dhe të krijojë regjistër të ndihmës shtetërore. Ndërsa, komisioni për ndihmë shtetërore funksionon si organ vendimmarrës lidhur me skemat e ndihmës shtetërore. Anëtarët e këtij komisioni emërohen nga Kuvendi i Kosovës.

Në Shqipëri çështjet që kanë të bëjnë me ndihmën shtetërore, qoftë vlerësimin e tyre por edhe marrjen e vendimeve, e bëjnë institucionet të cilat funksionojnë apo janë zgjedhur nga qeveria. Konkretisht, Drejtoria e Ndihmës Shtetërore, stafi i të cilës punon në ministritë e fushës së ekonomisë dhe mbledhet vetëm kur paraqitet nevoja, bën përgatitjen e vendimeve të ndihmës shtetërore për Komisionin dhe mban regjistrin e ndihmës shtetërore. Ndërsa, Komisioni i Ndihmës Shtetërore është organ vendimmarrës dhe është i emëruar nga Këshilli i Ministrave dhe i udhëhequr nga ministr-i/ja që vie nga fusha e ekonomisë.⁴

Në Maqedoninë e Veriut kompetencat për trajtimin e lëndëve të ndihmës shtetërore i ka Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës. Mirëpo, Komisioni nuk e ka si fushëveprim kryesor çështjen e ndihmës shtetërore, për çka nuk ka ndarë staf të mjaftueshëm për këtë fushë.⁵ Në Serbi, pas ndryshimeve në Ligjin për ndihmë shtetërore më 2019, Komisioni për Kontrollin e Ndihmës Shtetërore shndërrohet në institucion të pavarur që i raporton vetëm Kuvendit. Brenda këtij institucioni do të krijohet dhe veprojë edhe Këshilli i Ndihmës Shtetërore i cili është i obliguar që të adoptojë dhe përgatisë vendimet për Komisionin.⁶ Në Mal të Zi, pas ndryshimeve ligjore në vitin 2018, kompetencat për monitorimin dhe kontrollin e ndihmës shtetërore kanë kaluar tek Agjencia e Konkurrencës, ku janë krijuar institucione të reja, konkretisht Këshilli i Ndihmës Shtetërore, për mbulimin adekuat të kësaj fushe.⁷

4 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Ligji për Ndihmën Shtetërore. Burimi: <https://bit.ly/2OzNsj3>.

5 Dušan V. Popović. Korniza institucionale e organeve të ndihmës shtetërore në Evropën Juglindore. Faqe 73. Burimi: <https://bit.ly/2Sul6Yw>.

6 Parlamenti i Serbisë. Ligji për kontrollin e ndihmës shtetërore. Burimi: <https://bit.ly/2OByLfo>.

7 Kuvendi i Malit të Zi. Ligji për mbrojtjen e konkurrencës 2018. Burimi: <https://bit.ly/39hpErW>.

Tabela 1. Korniza institucionale e institucioneve të ndihmës shtetërore në Kosovë, Shqipëri, Serbi, Mal të Zi dhe Maqedoni të Veriut

	Institucioni përgjegjës për vlerësim të skemave dhe ndihmave individuale	Funksionimi i institucionit	Statusi	Institucioni vendimtarës	Funksionimi i institucionit
Kosova	Departamenti i Ndhmës Shtetërore	Pjesë e Ministrisë së Financave	Staf i përhershëm	Komisioni i Ndhmës Shtetërore	I emëruar nga Kuvendi ku anëtarët nuk mbajnë poste publike gjatë mandatit
Shqipëria	Drejtoria e Ndhmës Shtetërore	Pjesë e ministrive që mbulojnë çështjet ekonomike	Ad-hoc, varësisht nga nevoja për trajtimin e rasteve	Komisioni i Ndhmës Shtetërore	Të emëruar nga Këshilli i Ministrave, ku kryetar/e i komisionit është ministri/ja që mbulon çështjet ekonomike
Mali i Zi	Këshilli si pjesë e Agjencisë për Mbrojtjen e Konkurrencës	Institucion i pavarur	Staf i përhershëm	Këshilli i Ndhmës Shtetërore	
Serbia	Këshilli si pjesë e Komisionit të Ndhmës Shtetërore	Institucion i pavarur	Mandat 5 vjeçar	Komisioni i Ndhmës Shtetërore	I emëruar nga Kuvendi ku anëtarët nuk mbajnë poste në sektorin publik apo atë privat gjatë mandatit
Maqedonia e Veriut	Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës	Institucion i pavarur	Staf i përhershëm	Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës	

Për dallim nga Shqipëria, një përparësi të cilën e ka zgjedhur Kosova për ndërtimin e Komisionit të Ndhmës Shtetërore, ku anëtarët e tij janë të zgjedhur nga kuvendi dhe nuk janë ministra të qeverisë, konsiston në atë se shmanget një burim potencial i interesit. Kjo, pasi që ministrinë mund të jenë vetë dhënës potencial të ndihmës shtetërore të palejuar, dhe e njëjta mund të ndikojë në objektivitetin e tyre gjatë marrjes së vendimeve. Mirëpo, funksionimi i Departamentit të Ndhmës Shtetërore në kuadër të Ministrisë së Financave (MF), ndikon në pavarësinë që mund të ketë ky institucion, veçanërisht mund të trajtohet si konflikt interesi për rastet kur trajton skemat apo ndihmat individuale të dhëna nga MF ose ministrinë tjera. Andaj, do të ishte i rëndësishëm një ri-organizim dhe pavarësim operacional edhe i DNSH, duke zgjedhur ndonjë format të ngjashëm me atë të Serbisë, Malit të Zi apo Maqedonisë së Veriut. Por, e rëndësishme mbetet që pavarësimi i këtyre institucioneve të mbështetet me buxhet dhe staf të mjaftueshëm sikurse në rastin e Serbisë dhe Malit të Zi.


Në përgjithësi, vërehet një angazhim i pesë shteteve në Ballkanin Perëndimor për pavarësimin e institucioneve të ndihmës shtetërore edhe pse dallon korniza institucionale e zgjedhur nga to për të arritur këtë qëllim. Fillimisht, të gjitha shtetet i kanë krijuar institucionet e ndihmës shtetërore si pjesë të qeverisë, mirëpo me kalimin e kohës, duke përjashtuar Shqipërinë, ato kanë amandamentuar ligjet e ndihmës shtetërore. Siç tregon Tabela 2, shtetet si Serbia dhe Mali i Zi kanë arritur t'u krijojnë pavarësi të plotë këtyre institucioneve, pasi që ato i raportojnë direkt kuvendit dhe kanë staf të mjaftueshëm. Ndërsa, në rastin e Maqedonisë së Veriut, përkundrazi që institucionit të ndihmës shtetërore i është krijuar pavarësi në veprimin e saj, ajo mbetet pa staf të mjaftueshëm dhe ndihma shtetërore nuk është prioritet i institucionit nën të cilin vepron. Në Kosovë, kemi një pavarësi të pjesshme të institucioneve të ndihmës shtetërore, pasi që DNSH ende është pjesë e Ministrisë së Financave.

Tabela 2. Ndryshimet në kornizën institucionale lidhur më ndihmën shtetërore në Kosovë, Shqipëri, Serbi, Mal të Zi dhe Maqedoni të Veriut

	Korniza Institucionale fillestare	Korniza Institucionale pas amendamentimit të ligjit	Pavarësia
Kosova	Institucionet e ndihmës shtetërore pjesë e qeverisë	Komisioni i Ndihmës Shtetërore i pavarur, ndërsa Departamenti i Ndihmës Shtetërore pjesë e qeverisë	Institucionet e ndihmës shtetërore janë pjesërisht të pavarura
Shqipëria	Institucionet e ndihmës shtetërore pjesë e qeverisë	Nuk ka ndodhur amendamentim i ligjit ende	Asnjëri nga institucionet vendimmarrëse nuk është i pavarur
Mali i Zi	Institucionet e ndihmës shtetërore pjesë e qeverisë	Këshilli si pjesë e Agjencisë për Mbrojtjen e Konkurrencës	Institucionet e ndihmës shtetërore janë të pavarura
Serbia	Institucionet e ndihmës shtetërore pjesë e qeverisë	Këshilli si pjesë e institucionit të pavarur të Komisionit të Ndihmës Shtetërore	Institucionet e ndihmës shtetërore janë të pavarura
Maqedonia e Veriut	Institucionet e ndihmës shtetërore pjesë e qeverisë	Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës	Institucionet e ndihmës shtetërore janë të pavarura por me mungesë stafi. Dhe, fusha e ndihmës shtetërore nuk është prioritet i institucionit brenda të këto veprimeve

Sipas një raporti të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë të 2019, në të cilin vlerësohet puna, pavarësia dhe kapacitetet e organeve të ndihmës shtetërore të palëve kontraktuese, Kosova vlerësohet më dobët se sa shtetet fqinje të saj. Ky raport vë në pikëpyetje pavarësinë e DNSH dhe mungesën e stafit dhe resurseve teknike të këtij departamenti për zbatimin e ligjeve të ndihmës shtetërore. Konkretisht, më së larti janë vlerësuar organet e ndihmës shtetërore në Serbi me 75 nga 100%, Maqedonia e Veriut me 55%, Mali i Zi me 50%, Shqipëria me 35%, dhe Kosova me 25%. Raporti kritikon numrin e vogël të lëndëve të trajtuara nga këto institucione, stafin e pamjetueshëm dhe vë në pikëpyetje pavarësinë e disave nga to.⁸ Por, vlen të theksohet se nga koha e publikimit të këtij raporti të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, DNSH në Kosovë ka përgatitur tri raste për vendim për Komisionin e Ndihmës Shtetërore, dhe në të njëjtën kohë kanë ndodhur ndryshime në kornizën institucionale në këtë fushë në Serbi.

Figura 1. Puna, pavarësia dhe kapacitetet e organeve të ndihmës shtetërore të Kosovës, Shqipërisë, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut, dhe Serbisë, 2019



Burimi: GAP bazuar në të dhënat e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë

8 Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. Plani vjetor i implementimit 2019. Burimi: <https://bit.ly/374xALW>.

Puna e institucioneve të ndihmës shtetërore në Kosovë – rasti i termocentralit “Kosova e Re”

Departamenti i ndihmës shtetërore në Kosovë është themeluar në vitin 2017 dhe ka plotësuar stafin e saj prej shtatë anëtarësh gjatë vitit 2018. Ndërsa, Komisioni prej pesë anëtarësh për ndihmë shtetërore është emëruar nga Kuvendi në vitin 2019. Fokusi i DNSH-së mbetet në kompletimin e legjislacionit sekondar për ndihmë shtetërore, ku ka pasur ngecje në draftimin dhe miratimin e tyre bazuar në Agjendën për Reforma Evropiane dhe Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit 2019-2023. Tanimë, DNSH ka krijuar inventarin (regjistrin) ku përmes iniciativës së saj dhe komunikimit me institucionet publike ka identifikuar mbi 80 skema aktuale për të cilat duhet të merret vendim nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore. Sipas drejtorit të DNSH, mbi 90% e këtyre skemave kategorizohen si ndihma shtetërore të vogla dhe të lejueshme, që trajtohen sipas Rregullorës për ndihmën de minimis, pra të cilat nuk e dëmtojnë konkurrencën në treg dhe nuk krijojnë pozitë dominuese për subjekte të caktuara. Deri më tani, për tri nga këto raste, Komisioni për Ndhmë Shtetërore ka marrë vendime duke i kategorizuar si ndihma të lejueshme.⁹

Dilemat e ndihmës shtetërore në projektin “Kosova e Re”

Në skemat e ndihmës shtetërore të identifikuara nga DNSH, e për të cilat duhet të ekzistojë vendimi nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore, nuk bëjnë pjesë skemat apo ndihmat individuale shtetërore nga fusha e energjisë. Realisht, projekti për ndërtimin e termocentralit “Kosova e Re”, që përbën investimin me vlerën më të lartë që nga paslufta në Kosovë (1.3 miliardë euro) dhe në të cilin konsiderohet se ka elemente të shumta të ndihmës shtetërore, nuk është subjekt i një vlerësimi nga DNSH dhe Komisioni.

Më 2018, Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) ka nënshkruar kontratat komerciale me Contour Global (GenCo) për ndërtimin e termocentralit të ri “Kosova e Re”. Kontratat e nënshkruara parashohin që institucionet e Kosovës marrin për obligim (konkretisht Ndërmarrja e Re Energjetike (ang. NKEC) që do të themelohet nga qeveria) blerjen e gjithë kapacitetit dhe energjisë së prodhuar nga termocentrali 450 megavatësh i ndërtuar nga GenCo. Institucionet qeveritare nuk e kanë njoftuar DNSH për ndihmën që është planifikuar që t’i jepet këtij subjekti në treg, përkundër që DNSH ka ekzistuar nga viti 2018 dhe Ligji i ri për ndihmën shtetërore, më të cilin obligohet njoftimi i DNSH nga dhënësit potencial të ndihmës, ka qenë në fuqi nga viti 2017.

Me hyrjen në punë të termocentralit të ri, tregu i energjisë elektrike në Kosovë do të mbyllet për 20 vite, duke bllokuar kështu zhvillimin e çfarëdo konkurrence dhe minimizon mundësinë për liberalizim të tregut të energjisë. Furnizuesi aktual i energjisë elektrike (KESCO) dhe të tjerët që mund të fillojnë operimin në të ardhmen, do të obligohen të blejnë tërë energjinë elektrike nga NKEC, duke ua pamundësuar atyre blerjen e energjisë elektrike me çmim më të ulët në tregjet e energjisë elektrike për 20 vite. Si rrjedhojë, ky projekt e vë GenCo në një pozitë avantazhi mbi prodhuesit tjerë të energjisë elektrike në Kosovë duke e deformuar kështu konkurrencën. Specifikisht, ajo nuk u ofron prodhuesve tjerë, siç është KEK-u, kushtet e njëjta. Po ashtu, projekti parasheh që shpenzimet e GenCO për shfrytëzim të sistemit i ngarkohen ndërmarrjes shtetërore NKEC dhe që GenCo t’i transferohet pronë nën vlerën e tregut.¹⁰

Përkundër që DNSH dhe Komisioni për Ndhmë Shtetërore janë formuar së voni, ato sipas nenit 13.3 të Ligjit për ndihmë shtetërore të Kosovës, do të mund të kërkonin asistencë nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (SKE) për vlerësimin e projektit të termocentralit “Kosova e Re”.¹¹

9 Intervistë me Agim Krasniqin, Drejtor i Departamentit për Ndhmë Shtetërore në Kosovë, më 24 Janar 2020.

10 Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Kontratat komerciale të projektit TC “Kosova e Re”. Burimi: <https://bit.ly/37iQ6jy>.

Shih për më shumë detaje rreth prezencës së ndihmës shtetërore të palejuar në projektin “Kosova e Re” analizën e GAP analizën e GAP “Ndikimi i ndihmës shtetërore në tregun e energjisë elektrike në Ballkan”. Burimi: <https://bit.ly/2uAelfX>.

11 Gazeta Zyrtare. Ligji për Ndhmën Shtetërore. Burimi: <https://bit.ly/389em91>.

Meqenëse deri më tani nuk kemi ndonjë zhvillim rreth këtij projekti, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë para pak kohe ka nisur procedurën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes lidhur me projektin “Kosova e Re”. SKE ngrit shqetësimet lidhur me prezencën e ndihmës shtetërore të paligjshme në projektin në fjalë, ku thkesohen si ndihmë shtetërore hyrja në marrëveshje e institucioneve të Kosovës për blerje të energjisë elektrike për 20 vite, shitja dhe transferimi i pronës shtetërore nën çmimin e tregut, lirimi nga TVSH, dhe marrja përsipër nga Kosova e ngarkesave dhe shpenzimeve tjera.¹² Sipas Sekretariatit të Energjisë, në rast se projekti nuk përshtatet me rregullat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, lënda mund të sillet për shqyrtim para Këshillit të Ministrave pranë Komunitetit të Energjisë. Vendimi i Këshillit të Ministrave mund të rezultojë me pezullimin e të drejtave të Kosovës në votim dhe me përjashtimin e saj nga Këshilli.

Mos-veprimi i institucioneve të ndihmës shtetërore në një rast të tillë, krijon dëme për ekonominë dhe buxhetin e Kosovës, dhe mund të interpretohet si konflikt i interesit, ku DNSH nuk merr iniciativë të analizojë një projekt të inicuar nga një institucion tjetër i qeverisë.



¹² Komuniteti i Energjisë. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë nis procedurën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndaj Kosovës lidhur me prezencën e ndihmës shtetërore të palejuar në projektin “Kosova e Re”. Burimi: <https://bit.ly/2Sppxnz>.

Përfundime dhe rekomandime

Zgjedhja e kornizës institucionale ku institucioneve të ndihmës shtetërore u garantohet pavarësi në punën dhe financimin e tyre nga qeveria, mbetet hap i rëndësishëm për Kosovën dhe vendet e rajonit. Si mekanizëm, institucionet e pavarura të ndihmës shtetërore shërbejnë si ruajtës të parasë publike, por edhe konkurrencës së lirë në treg. Për më shumë, pavarësimi i tyre shmangë konfliktin e interesit gjatë vlerësimit të rasteve dhe marrjes së vendimeve. Nga pesë vendet e Ballkanit Perëndimor, formatet e zgjedhura nga Serbia apo Mali i Zi në ri-organizimin dhe pavarësimin operacional të institucioneve të ndihmës shtetërore janë më adekuate se sa ato të Maqedonisë së Veriut, Kosovës dhe Shqipërisë. Në rastin e Kosovës, është e rëndësishme që organet e ndihmës shtetërore të marrin për vlerësim projektin për ndërtimin e termocentralit “Kosova e Re” i cili përbën ndihmë shtetërore të palejuar, duke u dëmtuar kështu buxheti i Kosovës.

Lidhur me këtë temë është e rëndësishme që:

- Institucionet e ndihmës shtetërore duhet të marrin në trajtim të gjitha projektet për të cilat ekzistojnë indikacione që ka prezencë të ndihmës shtetërore. Prioritet duhet t’u jepet projekteve të mëdha që kanë kosto të lartë buxhetore dhe që mund të dëmtojnë kështu buxhetin e shtetit të Kosovës në rast të prezencës së ndihmës shtetërore të palejuar;
- Departamenti i Ndhmës Shtetërore (DNSH), përveç dërgimit të njoftimeve tek institucionet ku kërkohet që të prezantohen skemat apo ndihmat individuale që ato akordojnë, duhet të marrin iniciativën njëanshëm, sipas asaj çfarë i lejon ligji, të vlerësojë projekte në të cilat supozohet të ketë prezencë të ndihmës shtetërore të palejuar;
- Departamenti i Ndhmës Shtetërore dhe Komisioni i Ndhmës Shtetërore duhet t’i japin prioritet vlerësimit të projektit të “Kosovës së Re”, dhe duhet të kërkojnë asistencë teknike edhe nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë për vlerësimin e këtij projekti.



Embassy of the
Kingdom of the Netherlands

Ky raport është pjesë e projektit me titull “Mekanizmi i Monitorimit të Agjendës për Reforma Evropiane”, që financohet nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Kosovë, dhe implementohet nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Instituti GAP, dhe Instituti i Prishtinës për Studime Politike. Opinionet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë qëndrimet e Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Kosovë.



Group for Legal
and Political
Studies

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE



Kapacitetet dhe
pavarësia e institucioneve
për ndihmë shtetërore